



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:234323

Datë: 25.04.2024

Numri i dokumentit: 05617497

KPPP.nr.1758/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Arnis Dumani, në çështjen përbarimore të kreditorit Kompania Regjionale e Mbeturinave “Ekoregjioni” SH.A., me numër biznes 70465066, Njësia Operative Rahovec, kundër debitorit D.R.D. B.I., Ordinancë Stomatologjike “Vesa Dent” me numër biznesi 71154769 me seli në Rahovec, rruga “Xhelal Hajda”, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.580/21 të datës 23.09.2021 të Përbaruesit Privat Gjokë Radi nga Gjakova, jashtë seancës, me datë 25.04.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si i bazuar prapësimi i debitorit D.R.D. B.I., Ordinancë Stomatologjike “Vesa Dent” ANULOHET urdhri përbarimor P.nr.580/21 i datës 23.09.2021 i lejuar nga Përbaruesi Privat Gjokë Radi dhe PËRFUNDOHET në tërësi përbarimi në këtë çështje përbarimore.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania Regjionale e Mbeturinave “Ekoregjioni” SH.A., ka caktuar përbarimin përmes Urdhrit Përbarimor P.nr.580/21 të datës 23.09.2021 të lëshuar nga Përbaruesi Privat Gjokë Radi, me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm - Kartelës së konsumatorit Nr. L1074513 të lëshuar nga kreditori, me të cilin është detyruar debitori që në emër të përmbushjes së obligimeve të papaguara nga kartela e konsumatorit të lartcekur, brenda afatit prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrit t’ia paguajë kreditorit shumën prej 522.45€, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përbarimore, ashtu që të gjitha detyrimet të realizohen përmes zbatimit të përbarimit sipas llogarive bankare të debitorit dhe nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogarinë e tij bankare, përbarimi të zbatohet përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbartimor, duke theksuar ndër të tjerash se kërkesa e kreditorit është parashkruar sipas Ligjit Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve (tutje LMD), ngase nuk mund të kërkohej ekzekutimi nëse kanë kaluar më tepër se 1 vit, si dhe ka shtuar se me Spitalin e Përgjithshëm në Gjakovë ka lidhur marrëveshje për mbledhjen e mbeturinave nga ordianca e debitorit, në mënyrë që të njëjtat të djegën dhe asgjësohen. Gjykatës i ka propozuar që të anulohet urdhri i përmbartuesit privat.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, duke theksuar ndër të tjerash se propozimi për përmbartim i lejuar nga përmbartuesi privat i përmban të gjitha kriteret e përmbartueshmërisë për t'u konsideruar si dokument i besueshëm. Në lidhje me pretendimet e debitorit për marrëveshje me spitalin e Gjakovës, kreditori ka deklaruar se nuk bëhet fjalë për mbeturina toksike, por për mbeturina komerciale. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet prapësimi i debitorit si i palejueshëm dhe i pa bazë.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit si dhe shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (tutje LPP) dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet dhe procedura përmbartimore të përfundohej në tërësi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm - kartela e konsumatorit Nr. L1074513, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa në par. 2 të po këtij neni, si dokument i besueshëm sipas ligjit konsiderohen *“ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”*, ndërsa me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit monetar”*, kurse me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm,*

mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”.

Në rastin konkret pavarësisht faktit se propozimi për përmbardim është lejuar sipas Ekstraktit nga librat e kontabilitetit - Kartela Financiare e Konsumatorit në kuadër të Kompania Regjionale e Mbeturinave “Ekoregjioni” SH.A., gjykata gjen se dokumenti mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbardim, e mbi bazën e të cilit përmbarduesi privat ka lejuar përmbardimin, nuk i plotëson kushtet që të konsiderohet dokument i besueshëm për shkak që nuk i përmban tiparet e një ekstrakti nga librat afarist, meqenëse në këtë dokument nuk evidentohet saktësisht periudha kohore për të cilën kërkohet përmbardja e detyrimit.

Nga ekstrakti afarist i bashkëngjitur sipas shifrës Nr. 753419, figuron periudha kohore prej datës 01.01.2021 deri më datën 09.09.2021, mirëpo nga pasqyra evidentohen shuma nga data 01.01.2019 deri 01.12.2020, ndonëse në kartelë është cekur periudha vetëm për vitin 2021.

Meqenëse dokumenti në bazë të së cilit është lejuar urdhri përmbardimor, përkatësisht kartela e konsumatorit Nr. L1074513, nuk është dokument i besueshëm dhe nuk ka tipare të përmbardueshmërisë, gjykata nuk i shqyrtoi fare pretendimet tjera të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kreditorit të paraqitura në përgjigjen në prapësim dhe duke u bazuar në nenin 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenin 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbardimore, si dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1758/23 datë 25.04.2024.

Gjyqtari
Arnis Dumani

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.